



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 358 / Prot. 114

Vlorë më, 19.03.2025

VENDIM

Nr. 38, datë 19.03.2025

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT "ASISTENCË NË
GERIATRI"**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "*Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, reorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen dhe bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë*" si dhe referuar shkresës së Sektorit të Kurrikulave dhe Statistikave me nr. 951 datë 19.03.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 19.03.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e Programit të studimit "Asistencë në Geriatri" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shëndetit dhe Zëvendësrektori Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

RREGULLORJA E PROGRAMIT MËSIMOR:

DP në "ASISTENCË NË GERIATRI"

Neni 1

Baza ligjore e rregullores

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të:

- Ligjit Nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".
- Udhëzimit Nr.41, datë 24.01.2018 të MASH "Për elementë të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të lartë"
- Statutit të rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës
- Rregullores së Fakultetit të Shëndetit
- Rregullores së Departamentit të Infermierisë

Neni 2

Emërtimi dhe statusi i programit

Programi mësimor DP në "Asistencë në Geriatri" është program 2-vjeçar profesional, i ofruar nga Departamenti i Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë,

Ky program mësimor është i organizuar në dy vite akademikë (4 semestra) dhe në përfundim të tij studentët grumbullojnë minimalisht 120 ECTS dhe marrin diplomën: DP në "Asistencë në Geriatri".

Neni 3

Objektivat formuese të programit të studimit DP në "Asistencë në Geriatri"

Programi mësimor Profesional "Asistencë në Geriatri" formon punonjës të kualifikuar në profilin "Shërbime geriatrike", në përputhje me misionin madhor të FSH, që është të rrisë standartet e kujdesit ndaj adultëve të moshave madhore, nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe komunikimit.

Ky program mësimor synon formimin të profesionistëve me aftësi shkencore dhe profesionale për të aplikuar kujdesje për moshat geriatrike në drejtim të ushqyerjes, sëmundshmërisë, mirëqënies, dhe parandalimit. Spektri i kujdesjeve po vjen duke u zgjeruar vazhdimisht dhe programet që ne ofrojmë synojnë formimin e specialistëve profesionistë për të sotmen e për të ardhmen.

Objektivat e këtij programi përfshijnë:

- Plane bashkëkohore të kujdesit geriatrik.
- Të menduarit kritik në gjykimet dhe vendim-marrjet profesionale.
- Të mësuarit e bazuar në problem.
- Komunikimin efektiv me të tjerët.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETTIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

➤ Kontributin në rritjen e kapaciteteve shëndetsore komunitare.

Gjatë gjithë periudhës së formimit studentit do t'i duhet të zhvillojë aftësitë e nevojshme për të kontribuar në dhënien e përkujdesjeve cilësore, me qëllim që të ndikojë në përmirësimin e shëndetit të moshave geriatrike.

Neni 4

Lista e disiplinave mësimore, të ndara në module dhe veprimtari të tjera formuese.

Ndarja e moduleve sipas veprimtarive formuese				
		Kodi	Lënda	Kreditet
Lëndë bazë: A (18 kredite)	1.	ASG 101	Principet e komunikimit / geriatri	3
	2.	ASG 107	Etika profesionale/ geriatri	3
	3.	ASG 108	Legjislacion profesional	3
	4.	ASG 105	Terminologji mjekësore / geriatri	3
	5.	ASG 160	Parandalim Klinik në shërbim të popullatës	3
	6.	ASG 210	Bazat e Sociologjisë	3
				18
Lëndë karakterizuese: B (65 kredite)	7.	ASG 102	Higjenë / geriatri	3
	8.	ASG 201	Geriatri	5
	9.	ASG 140	Patologjitë kronike të moshat e treta	3
	10.	ASG 209	Trajtim farmaceutik, Farmakoterapi tek të moshuarit	4
	11.	ASG 202	Dhënia e ndihmës së parë tek i moshuari	3
	12.	ASG 208	Kujdes Paliativ në Geriatri	3
	13.	ASG 180	Terapi rehabilituese në Geriatri	3
	14.	ASG 204/205	Përkujdesje në Traumë/Përkujdesje geriatrike në ORL-okulistikë	3
	15.	ASG 203	Dietoterapi në Geriatri	3
	16.	ASG 206	Bazat e Shëndetit Mendor / geriatri	3
	17.	ASG 170	Formim praktik - geriatri I	10
			Zbatimi i etikës dhe sjelljes profesionale në Shërbimin Geriatrik	2
			Matja e shenjave jetësore të organizmit	2
			Zbatimi i masave parandaluese shëndetësore	2
			Kryerja e përkujdesjeve trupore – higjena, ushqyerja, veshja, larja, rregullimi i shtratit	2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	18.	ASG 220	Pastrimi-dezinfektimi	2
			Formim praktik - geriatri II	22
			Dhënia e ndihmës së parë tek i moshuari	3
			Përkujdesja për motoricitetin e përgjithshëm, skemën trupore dhe motoricitetin e pacientit geriatrik	3
			Përkujdesja ndaj individit të së sëmure dhe administrimi i barnave	3
			Përkujdesja në çrregullimet e frymëmarrjes dhe sëmundjet kardiovaskulare tek i moshuari	3
			Përkujdesja në aftësimin e pacientit me aftësi të kufizuar dhe mekanika trupore	2
			Përkujdesja në çrregullimet e Aparatit Gastrointestinal dhe Urogenital tek i moshuari	2
			Përkujdesja në problematikat e dëgjimit dhe shikimit (me zgjedhje)	3
			Ndihma ndaj pacientit geriatrik gjatë procesit të rehabilitimit (me zgjedhje)	3
				65
Lëndë ndërdisiplinore / integruese: C (17 kredite)	19.	ASG 220	Anatomi Humane	4
	20.	ASG 220	Fiziologji normale	4
	21.	ASG 220	Shërbime shëndetësore bazë I (Geriatrike)	5
	22.	ASG 220	Shërbime shëndetësore bazë II	4
				17
Lëndë plotësuese: D (14 kredite)	23.	ASG 130	Gjuhë e huaj	3
	24.	ASG 214	Rrjetet sociale për mbrojtjen e të moshuarve	2
	25.	ASG 207	Teknologjitë e reja në dispozicion të moshave të treta	3
	26.	ASG 103	Kujdesi Shëndetsor Parësor në moshën e tretë dhe të katërt	3
	27.	ASG 109	Organizim i Sistemit Shëndetsor	3
				14
Detyrime përmbyllëse: E (6 kredite)	28.	ASG 230	Përgatitje për provim përfundimtar / temë diplome	6
Total				120



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Neni 5

Plani mësimor i programit DP në "Asistencë në Geriatri"

Plani mësimor i këtij programi gjendet në faqen 18-21 të këtij dokumenti.

Neni 6

Objektivat formues specifike të çdo disipline apo veprimtaritë e tjera formuese

KATALOGU I MODULEVE TË PROGRAMIT DP në "Asistencë në Geriatri"

ASG 101 Principet e komunikimit (3 ECTS)

Në këtë modul studentëve u ofrohet mundësia për të rritur aftësitë e tyre në artin e komunikimit për nevojat e kujdesit shëndetësor dhe terapeutik të moshave geriatrike. Komunikimi është një tipar thelbësor i kujdesit shëndetësor dhe një nga rolet kryesore që duhet të ndër marrin profesionistët e shëndetit. Ky modul do të ndihmojë të përvetësohen praktikat dhe bazat teorike të aftësive të komunikimit për t'u angazhuar me adultët madhorë dhe familjet e tyre. Krahas faktit që përcakton mosha e madhe do të merret parasysh zhvillimi i jetës së tyre si dhe konteksti social, kulturor, ligjor dhe politik. Komunikimi efektiv është vendimtar për ofrimin e kujdesit cilësor të kujdesit profesional dhe krijimin e partneritetit profesional profesionist-familje. Gjithashtu theksohen disa nga elementet kryesore të komunikimit dhe aftësive ndërpersonale, krahas perspektivave teorike kryesore dhe modeleve të komunikimit, për t'u marrë parasysh kur merren me adultët e moshave geriatrike.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

1. Të aftësohet në përdorimin e komunikimit si një mjet efikas dhe i rëndësishëm në ofrimin e kujdesit geriatrik.
2. Të dijë cilat lloje të komunikimit të përdorë në situata të ndryshme sipas gjendjes shëndetësore, mendore dhe sociale të pacientëve.
3. Të përdorë komunikimin si mjet empatik për të kuptuar qëllimet e pacientit dhe të transmetojë qëllimet e veta në përkujdesje.
4. Të komunikojë në mënyrë adekuate me familjen dhe të dijë ndryshimin midis këshillimit, trajnimit dhe informimit.

ASG 107 Etikë profesionale (3 ECTS)

Në këtë modul studenti merr njohuri të plota mbi tërësinë e normave morale që karakterizojnë sjelljen e personelit shëndetësor gjatë ushtrimit të profesionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETTIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të kenë njohuri mbi normat morale dhe juridike që rregullojnë mbarëvajtjen e profesionit të kujdestarit shëndetësor.
- ☞ Të formojnë shprehje për të gjykuar në mënyrë të pavarur marrjen e vendimeve etiko-deontologjike në praktikën shëndetsore.

ASG 108 Legjislacion profesional (3 ECTS)

Në këtë modul studenti merr njohuri të plota mbi tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve ligjore të personelit që ofron kujdes shëndetësor, si dhe mbi prioritetet strategjike të politikave shëndetësore të sotme.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të njohin të drejtat dhe detyrimet e pacientëve.
- ☞ Të njohin të drejtat dhe detyrimet ligjore të personelit shëndetësor, dhe në mënyrë specifike të personelit geriatrik për aspekte të ndryshme të legjislacionit në shëndetsi.
- ☞ Të kenë njohuri për strategjitë kombëtare të ruajtjes dhe përmirësimit të shëndetit të popullatës.
- ☞ Të formojnë shprehje për të gjykuar në mënyrë të pavarur marrjen e vendimeve etiko-deontologjike në praktikën shëndetësore.

ASG 105 Terminologji mjekësore (3 ECTS)

Terminologjia mjekësore është një lëndë në të cilën studentët marrin njohuri mbi termat më të përdorshme latine dhe greke, fjalëformimi në këto gjuhë, morfologji, formim i recetës si dhe përdorimi i tyre klinik. Të kuptojnë e të përdorin shprehje të jetës së përditshme si dhe të jenë të aftë të përkthejnë materiale të shkencës mjekësore. Në këtë modul futen dhe seminarët të cilat synojnë të diskutojnë dhe kontrollojnë njohuritë që studentët marrin gjatë leksioneve.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të kuptojnë e të përdorin shprehje të jetës së përditshme.
- ☞ Të jenë të aftë të përkthejnë materiale të shkencës mjekësore
- ☞ Të kuptojnë e të përdorin fjalorin e terminologjisë mjekësore në gjuhën latine.

ASG 103 Kujdesi Shëndetsor Parësor në moshën e tretë dhe të katërt (3 ECTS)

Shëndeti shëndetsor parësor trajton kryesisht faktorët që ndikojnë në shëndetin e një komuniteti geriatrik, duke vendosur theksin në parandalimin e sëmundjeve, edukimin shëndetësor dhe aktivitetet promovionale.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETTIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

☞ Të identifikojnë problemet e shëndetit paresor ne moshat geriatrike.

ASG 210 Bazat e sociologjisë (3 ECTS)

Kjo lëndë ofron një hyrje për problemet, çështjet, temat dhe idetë kryesore të Sociologjisë. Ajo ka për qëllim të përcjellë faktet themelore sociale në shoqëri duke u mundësuar studentëve që të miratojnë një qasje shkencore për kuptimin dhe interpretimin e fenomeneve sociale dhe të zhvillojnë imagjinatën e tyre sociologjike mbi problemet e natyrës sociale, ekonomike dhe politike.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të aplikojnë konceptet themelore dhe format e analizës në sociologji.
- ☞ Të identifikojnë, përshkruajnë dhe shpjegojnë aspektet kryesore të funksionimit të marrëdhënieve shoqërore.
- ☞ Të zhvillojnë të menduarit kritik lidhur me marrëdhëniet ndërmjet fenomeneve të ndryshme shoqërore.
- ☞ Të aplikojnë një qasje multi-disiplinare në interpretimin e çështjeve të ndryshme që ndodhin në shoqëri
- ☞ Të njihen me metodologjinë empirike dhe të zhvillojnë shkathtësinë në përdorimin e teknikave të kërkimit empirik

ASG 102 Higjenë (3 ECTS)

Ky modul u ofron studentëve informacione mbi ruajtjen e një higjene optimale në institucionet e ofrimit të kujdesit shëndetësor geriatrik. Këtu studenti merr njohuri mbi infeksionet, zinxhirin e transmetimit, llojet e mikroorganizmave infektive dhe rezistentë. Mënyrat e parandalimit të infeksioneve, pastrimi, desinfektimi dhe sterilizimi dhe mjetet e tyre. Legjislacioni Shqiptar dhe Evropian gjithashtu trajtohet në këtë subjekt, duke sjellë aspektet më kryesore që duhen respektuar në cdo institucion.

Objektivat e modulit:

- Të ofrojë informacion mbi llojet e infeksioneve dhe mënyrën e përhapjes së tyre
- Të ofrojë informacion mbi masat parandaluese për përhapjen e infeksioneve
- Të ofrojë informacion mbi insitucionet e higjenës në Shqipëri dhe protokollat që dalin prej tyre për zbatim
- Të ofrojë informacion mbi mënyrat e mbrojtjes personale nga infeksionet e shkaktuara nga mikroorganizmat patogjene rezistentë

ASG 201 Geriatri (5 ECTS)

Geriatria është shkenca mjekësore që përfshin patologjitë kryesore të plakjes, si të gastro-hepato-enterologjisë, nefrologjisë, kardiovaskulare, aparatit të frymëmarrjes dhe reumatizmale. Gjithashtu trajtohen patologjitë kryesore që prekin moshat e treta. Njohja me shenjat e sëmundjes, profilaksia dhe mjekimi zënë një vend të konsiderueshëm pa lënë mënjanë metodat parandaluese sepse të parandalosh është më lehtë se të kurosh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të kenë njohuri për ndërtimin dhe funksionin e organeve dhe sistemeve.
- ☞ Të kenë njohuri mbi shkaktarët dhe simptomat e sëmundjes.
- ☞ Të kenë njohuri me metodat parandaluese të sëmundjes.
- ☞ Të ketë aftësi për ruajtjen e parametrave vitalë, teknikave të asistencës dhe trajtimin e sëmundjeve.
- ☞ Të formojnë shprehje për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe të sugjerojnë rekomandime për ndërhyrje në sistem.

ASG 140 Patologjitë kronike të moshat e treta (3 ECTS)

Gerontologjia është studimi i aspekteve fizike të plakjes, si dhe i implikimeve mendore, sociale dhe shoqërore të plakjes. Ndryshe nga geriatra, e cila përqendrohet në aspektet mjekësore të trupave të plakjes dhe se si ato ndryshojnë dhe përshtaten me ndryshimet në vitet e vjetra, fusha e gerontologjisë ka një fokus shumëdisiplinor. Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të kenë njohuri mbi aspektet sociale dhe kulturore të plakjes
- ☞ Të kenë njohuri mbi aspektet biologjike të plakjes
- ☞ Të kenë njohuri mbi aspektet psikologjike dhe konjitive të plakjes
- ☞ Të formojnë shprehje për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe të sugjerojnë rekomandime për ndërhyrje në sistem.

ASG 204/205 Përkujdesje në Traumë/Përkujdesje geriatrike në ORL-okulistikë (3 ECTS)

Traumatologjia është një lëndë që zhvillohet në vitin e dytë. Në programin e saj jemi përpjekur të japim konceptet e përgjithshme për të gjitha traumat dhe politraumat në mënyrë që një asistent të ketë bagazhin e nevojshëm për tu punësuar në mënyrë që të ofrojë përkujdesje geriatrike.

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të diagnostikojnë traumat kryesore të periudhës nga momenti i aksidentit deri në trajtimin spitalor.
- ☞ Të diagnostikojnë klinikisht patologjitë kryesore traumatike geriatrike.
- ☞ Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të traumave.
- ☞ Të prezantojnë raste klinike tërësore: nga etiologjia tek plani i asistencës.

Otorinolaringologjia (ORL) është shkencë që studion veshin, fytyrën, hundën dhe gypin trakeobronkial. Në këtë specialitet studenti merr informacion mbi anatominë e veshit, sëmundjet më të shpeshta në ORL dhe asistencën në moshat geriatrike.

Okulistika është shkencë që studion ndërtimin dhe funksionimin e syrit. Studenti në këtë specialitet do të marrë informacion mbi anatominë, fiziologjinë, fizipatologjitë e syrit dhe kujdesin shëndetësor për shumë sëmundje të syve në moshat geriatrike.

Do të njihen me objektin e studimit të shkencave më të bukura të Mjekësisë: Okulistikë/ORL



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

- Do të kenë njohuri të mjaftueshme për anatomicën, fiziologjinë dhe fizpatologjinë e syrit
- Do të mund të realizojnë kujdesje shëndetësore për shumë sëmundje që studion kjo shkencë.
- Do të dinë të realizojnë përkujdesjet shëndetësore në rastet emergjente.
- Do të kenë njohuri të mjaftueshme për anatomicën veshit, hundës, laringut, faringut.
- Do të mund të realizojnë kujdesje shëndetësore për shumë sëmundje që studion kjo shkencë.

ASG 208 Kujdes Paliativ në geriatri (3 ECTS)

Në lëndën e "Kujdesit Paliativ në Geriatri", studentët do të përgatiten për kujdesin në pacientët me sëmundje kronike, onkologjike si dhe lehtësimin e dhimbjes dhe përmirësimin e simptomave në këta pacientë

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të sëmundjeve kronike të moshuarit.
- ☞ Të prezantojnë raste klinike tërësore: nga etiologjia tek plani i asistencës.
- ☞ Të kuptojnë rolin e profesionistit të shëndetit në ofrimin e kujdesit paliativ cilësor.
- ☞ Të diskutojnë dhe interpretojnë aspektet e vlerësimit psikologjik, shpirtëror dhe social të cilësisë së jetës.

ASG 180 Terapi Rehabilituese në geriatri (3 ECTS)

Ndihma ndaj pacientit geriatrik gjatë procesit të rehabilitimit është një lëndë formuese profesionale, e bazuar në ndërhyrjet mbi procesin e paaftësisë së të moshuarit, që synon të parandalojë përkeqësimin e paaftësisë dhe invaliditetin.

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të njohin parimet e praktikës fizioterapeutike.
- ☞ Të diferencojnë benefitet e modaliteteve të ndryshme fizioterapeutike në patologji të veçanta.
- ☞ Të realizojnë procedurat të ndryshme fizioterapeutike në bazë të mendimit kritik.
- ☞ Të veprojnë duke respektuar indikacionet dhe kundërindikacionet e përdorimit të modaliteteve fizioterapeutike.

ASG 203 Dietoterapi në geriatri (3 ECTS)

Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuritë bazë për ushqyerjen, lidhjen midis ushqyerjes dhe shëndetit, si dhe ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit në moshat geriatrike nëpërmjet dietoterapisë. Orët e seminareve të lëndës në fokus do të kenë diskutimin e temave të dhëna në teori dhe mënyrën e implementimit sa më të mirë të tyre në praktikë.

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje të:

- ☞ Përshkruajnë lidhjen midis ushqyerjes dhe shëndetit; tretjen; absorbimin dhe metabolizmin. Analizojnë grupet ushqyese (karbohidratet, yndyrnat, proteinat, vitaminat).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

- ☞ Ruajnë dhe përmirësojnë shëndetin e pacientëve geriatrik nëpërmjet ushqyerjes së shëndetshme nga njohuritë e marra, përfshirë tema mbi ushqyerjen – të lidhura me sëmundjet më të shpeshta në moshat geriatrike.
- ☞ Diskutojnë në lidhje me sëmundje të ndryshme në moshat geriatrike dhe rolin e dietoterapisë për kontrollin e këtyre sëmundjeve.
- ☞ Vlerësojnë nevojat ushqimore të pacientëve geriatrik në përputhje me gjendjen shëndetësore të tyre.

ASG 206 Bazat e shëndetit mendor (3 ECTS)

Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuri profesionale në fushën e kujdesit shëndetësor në neurologji dhe në patologjitë psikiatrike në moshat treta. Shëndeti mendor studion kujdesin shëndetësor për personat e prekur nga sëmundje të SNQ dhe crregullime të psikikës si dhe trajtimin e problemeve që mund të shfaqen gjatë periudhës së tretë të jetës. Gjithashtu studentët do të mësohen të njohin dhe të trajtojnë sëmundjet më të shpeshta që dëmtojnë Shëndetin Mendor në moshat geriatrike. Vlerësimi dhe njohja e klinikës do të ndihmojnë studentin në ndërhyrjet e nevojshme.

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të diagnostikojnë patologjitë kryesore të SNQ dhe SNP dhe të ndërhyjnë sipas protokolleve.
- ☞ Të diagnostikojnë klinikisht patologjitë psikopatologjike dhe të bashkëpunojnë në grup multidisiplinar.
- ☞ Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të sjelljes me të sëmurët mendor.
- ☞ Të prezantojnë raste klinike tërësore: nga etiologjia tek plani i asistencës

ASG 209 Trajtim farmaceutik, Farmakoterapi tek të moshuarit (4 ECTS)

Është lëndë paraklinike e cila ka për qëllim të prezantojë konceptet bazë të farmakologjisë geriatrike. Gjithashtu do të paraqitë të gjitha klasat e barnave që përdoren në fushën geriatrike dhe bimët më të rëndësishme mjekësore si dhe përdorimi i tyre.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të njohin dhe të përshkruajnë bazat e farmakokinetikës dhe farmakodinamikë geriatrike
- ☞ Të njohin dhe të përshkruajnë klasat madhore farmakologjike në moshën geriatrike
- ☞ Të njohin toksikologjinë pediatrike dhe të përmend disa nga atidotët e emergjencës geriatrike
- ☞ Të njohin disa nga bimët më të rëndësishme medicinale dhe rëndësinë e tyre.

ASG 202 Dhënia e ndihmës së parë (3 ECTS)

Një modul praktik që e pajis studentin me aftësi për të dhënë ndihmën e parë në raste fatkeqësish, sëmundjesh akute, aksidentesh dhe të tjera rreziqe për jetën sipas protokolleve dhe metodave të njohura, si dhe për të evidentuar dhe dokumentuar të dhëna të thjeshta



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

menjëherë në vend-ngjarje dhe gjatë transportit deri në qendrën mjekësore me të afërt, duke zbatuar edhe rregullat e institucionit për ndihmën e parë.

Studenti merr njohuri mbi:

- ☞ Përcaktimi i prioriteteve të veprimit.
- ☞ Pozicionimi i të dëmtuarit në pozicionin e përshtatshëm
- ☞ Vlerësimi i gjendjes së komunikimit të të dëmtuarit.
- ☞ Vlerësimi i frymëmarrjes së të dëmtuarit, dispnesë, lirimi i tyre, kontrolli i pulsit (ritmit dhe fortësisë).
- ☞ Vlerësimi i gjakosjes/hemoragjisë së të dëmtuarit.
- ☞ Vlerësimi i madhësisë dhe gravitetit të plagëve.
- ☞ Vlerësimi i dëmtimeve kockore.
- ☞ Vlerësimi i dhimbjeve të forta
- ☞ Vlerësimi i ndjenjës së të vjellave
- ☞ Vlerësimi i rritjes së temperaturës trupore
- ☞ Sigurimi i transportimit të të dëmtuarit

ASG 170 Formim praktik – geriatri I (10 ECTS)

Praktika kryhet në institucione shëndetsore ose shtëpi kujdesi për mosha geriatrike. Ky model i aftëson studentin për të marrë njohuri të përgjithshme dhe profesionale në mënyrë që të kryejë përkujdesje për të moshuar në nevojë duke respektuar rregullat etike dhe profesionale. Studenti këtu do të marrë njohuri bazë mbi matjen e parametrave vitalë, higjenën dhe nevojat bazë humane. Gjithashtu ky modul i aftëson studentët të praktikojnë në praktike rregullat e pastrimit, dizinfektimit dhe sterilizimit në institucione të kujdesit shëndetsor.

Objektivat e modulit:

- Të aftësojë studentin në mënyrën e duhur të ofrimit të ndihmës tek pacientët dhe stafi
- Studenti duhet të jetë në gjendje të zbatojë etikën dhe sjelljen profesionale në Shërbimin Geriatrik
- Matja e shenjave jetësore të organizmit
- Kryerja e përkujdesjes trupore - higjena. Ushqyerja, veshja, larja, rregullimi i krevatit.
- Pastrimi, dezinfektimi dhe sterilizimi.
- Të ofrohet shërbim geriatrik duke mbrojtur pacientët dhe mjedisin ku ata trajtohen

ASG 220 Formim praktik – geriatri II (20 ECTS)

Praktika kryhet në institucione shëndetësore ose shtëpi kujdesi për mosha geriatrike. Ky model i aftëson studentët për të marrë njohuri të përgjithshme dhe profesionale në mënyrë që të kryejë përkujdesje për të moshuar në nevojë duke respektuar rregullat etike dhe profesionale. Studenti do të praktikojë përkujdesjet për të moshuarit duke ofruar barnat, duke u kujdesur për probleme të ecjes dhe posturës, dëgjimit dhe shikimit, të japë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

ndihmën e parë në situatë të ndryshme, të ruajë lëvizjet motorike normale për moshën, të përkujdeset për pacientët me probleme kardiovaskulare dhe gastrointestinale.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Studenti duhet të jetë në gjendje të ofrojë kujdeset e përshtatshme të shërbimit geriatrik dhe të prezantojë veten tek i moshuari të cilit do i ofrojë ndihmë
- ☞ Studenti duhet të jetë në gjendje të prezantojë veten me stafin e qendrës që ofron shërbim për të moshuarit
- ☞ Studenti duhet të jetë në gjendje të ofrojë përkujdesjet bazë dhe administimin e barnave tek moshat geriatrike
- ☞ Studenti duhet të jetë në gjendje të ofrojë përkujdesjet praktike për pacientët me patologji kardiovaskulare dhe gastrointestinale
- ☞ Studenti duhet të jetë në gjendje të ofrojë përkujdesjet geriatrike për pacientët me probleme të ecjes, aftësi të kufizuara dhe problemet motorike
- ☞ Studenti duhet të jetë në gjendje të ofrojë përkujdesjet tek pacientët me probleme të dëgjimit dhe shikimit
- ☞ Studenti duhet të zbatojë rregullat e institucionit dhe etikën profesionale për kujdesin e ofruar ndaj pacientëve geriatrikë.
- ☞ Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit
- ☞ Të prezantojë punën e përditshme që kryejnë qendrat që ofrojnë shërbime për të moshuar

ASG 104 Anatomi humane (4 ECTS)

Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuritë bazë mbi sistemet e organizmit, formën, ndërtimin, strukturën dhe funksione të tyre.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të njohin parimet bazë të studimit të anatomisë.
- ☞ Të evidentojnë dhe të njohin strukturat e ndryshme anatomike të trupit të njeriut.
- ☞ Të vlerësojnë zbatimin praktik të anatomisë në fushat e ndryshme mjekësore.
- ☞ Të njohin mekanizmat bazë të proceseve fiziopatologjike më të shpeshta të trupit të njeriut.

ASG 150 Fiziologji normale (4 ECTS)

Është lëndë paraklinike që i pajis studentët me njohuritë e nevojshme për funksionimin normal të organizmit të njeriut, duke filluar nga funksionet e qelizës dhe duke vazhduar me funksionet e çdo sistemi organesh në veçanti.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të njohin funksionimin normal të organizmit.
- ☞ Të diferencojnë normalen nga patologjika kur të hyjnë në lëndët klinike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

ASG 110 Shërbime shëndetësore bazë I (5 ECTS)

Shërbime shëndetësore bazë është një lëndë formuese profesionale, e bazuar në tematikat komplekse që shtjellon si procedurat për kujdesëse bazë, principet bazë të kujdesjeve shëndetësore.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të realizojnë për kujdesjet shëndetësore në bazë të mendimit kritik.

ASG 120 Shërbime shëndetësore bazë II (4 ECTS)

Shërbime shëndetësore bazë është një lëndë formuese profesionale, e bazuar në tematikat komplekse që shtjellon si procedurat për kujdesëse bazë, principet bazë të kujdesjeve shëndetësore.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të realizojnë për kujdesjet shëndetësore në bazë të mendimit kritik

ASG 207 Teknologjitë e reja në dispozicion të moshave të treta (3 ECTS)

Lënda Teknologjite e reja në dispozicion të moshave të treta është një lëndë që ndërthur dy fusha të rëndësishme në jetën e sotme të organizatave, Sistemet e Informacionit me elementët e tyre përbërës: hardware, software, telekomunikimin dhe shëndetësinë.

Lënda ka një aspekt praktik shumë të gjerë dhe do të përpiqet të njohë studentët me përfitimet e përdorimit të teknologjisë dhe sistemeve të informacionit inovatore në ecjen përpara të menaxhimit shëndetësor të informatizuar, por edhe në fusha të tjera të shërbimit geriatrik. Por, aspekti praktik i përfshirë në program përbën vetëm një pjesë të sistemeve të informacionit në tërësinë e tyre, atë të bazës së të dhënave. Synohet që studentët të shohin në praktikë edhe tipe të tjera të SI.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje të:

- ☞ Të përdorin sistemet elektronike të informatizimit të të dhënave mjekësore spitalore dhe në internet.

ASG 130 Gjuhë e huaj (3 ECTS)

Është një lëndë e cila pëgatit studentët me bazat e gramatikës në gjuhën e huaj e cila është shumë e rëndësishme me qëllim përdorimin e gjuhës korrekte gjatë kujdesjeve shëndetësore..

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje të:

- ☞ Përdorimi korrekt e gramatikës në gjuhën e huaj
- ☞ Leximi korrekt i teksteve të ndryshme.
- ☞ Përdorimi i termave kryesore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

ASG 109 Organizim i Sistemit Shëndetsor (3 ETC)

ASG 160 Parandalim Klinik në shërbim të popullatës (3 ETC)

ASG 214 Rrjetet sociale për mbrojtjen e të moshuarve (2 ETC)

ASG 230 Diploma (provim / temë) në DP në "Shërbime Geriatrike" (6 ECTS)

Formimi i studentit në programin mësimor DP "Shërbime Geriatrik" mbyllet me provim formues ose me prezantimin e një punimi shkencor nën udhëheqjen e një pedagogu. Për realizimin e këtij punimi shkencor studenti do të marrë të dhënat nga shërbimi parësor dhe dytësor, dhe institucionet e kujdesit shëndetësor geriatrik në të cilat do të kryejë praktikën profesionale.

Tematika e punimeve shkencore do të përzgjidhet nga aspektet e ndryshme të kujdesjeve shëndetësore ndaj moshave geriatrike.

Formimi formues do të përfshijë njohuritë e fituara të studentëve në lëndët e ndjekura në këtë program mësimor gjatë 3 semestrave të parë.

Neni 7

Syllabuset e ofruara studentëve

Syllabyset e lëndëve/moduleve, të ofruara për studentët nga Departamenti i Infermierisë, janë paraqitur në mënyrë të detajuar nga faqja 25 deri në faqen 184 të këtij dokumenti, dhe përditësohen e shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës.

Programi i plotë i kurrikulave mësimore të ofruara për studentët e Departamentit të Infermierisë për programin DP në "Asistencë në Geriatri" mund të tërhiqet tek Sekretaria Mësimore e Departamentit, pas pagesës përkatëse.

Neni 8

Format dhe organizimi i studimit të programit DP në "Asistencë në Geriatri"

Në programin mësimor DP në Asistencë në Geriatri veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit ndahen në:

- mësim në auditor (leksione, ushtrime, seminare, laboratore),
- studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës etj)
- veprimtari të tjera (profesionale). (VKM Nr.41, dt.24.01.2018, pika 2.4)

Leksionet, seminarët dhe labororet zhvillohen në ambientet e Universitetit 'Ismail Qemali' Vlorë, Fakulteti i Shëndetit, godina "D", "C", "B".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Praktikat profesionale zhvillohen në institucionet shëndetsore parësore dhe dytësore, qëndra komunitare të shërbimit ditor për adultë dhe shtëpi për të moshuar nën drejtimin e pedagogut të caktuar. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, punonjësi mësimor që e drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me qendrën ku ajo kryhet.

Grupet mësimore të këtij programi organizohen si më poshtë: (VKM Nr.41, dt.24.01.2018, Tabela Nr.2)

Grup mësimor për leksione:	25-100 studentë.
Grup mësimor për seminare,	25 studentë.
Grup mësimor për laboratore	10 - 20 studentë.
Grup mësimor për praktika profesionale	20 studentë.

Neni 9

Format e provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët

Programi mësimor DP në "Asistencë në Geriatri" parashikon në total 28 vlerësime përfundimtare të dijeve, duke përfshirë vlerësimet përfundimtare të lëndëve mësimore, të praktikës profesionale dhe tezës së diplomës.

Format e kontrollit të dijeve përfshijnë detyrat e kursit, projektet, provimet e kursit, provimet e formimit, provimet praktike (prezantime të procedurave të ndryshme në mulazhe apo pacientë realë), temat e diplomave.

Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (projektet/detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final).

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet:

- a) me shkrim,
- b) me gojë,
- c) i kombinuar, me shkrim e me gojë

duke u mbështetur në programin mësimor. Vlerësimi përfundimtar i modulit bëhet një provim përfundimtar, plus kërkesat specifike që vendos çdo pedagog për lëndën dhe që pasqyrohen në vlerësimin e vazhdueshëm.

Në përfundim të programit të studimit studentit i njehsohet Nota Mesatare e Ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

Neni 10

Kushtet për tu konsideruar kalues në një lëndë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, ... , 10. Notat nga pesë e lartë janë kaluese.

Në format e kontrollit me shkrim (provime, detyra/projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, konvertohet në notë. Në vlerësimin final të lëndës pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/projekteve të kursit).

Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo syllabys, por minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është $\geq 40\%$ në të gjitha modulet. Ulja e këtij kufiri mund të bëhet pas daljes së rezultateve të të gjithë grupit, me propozim të pedagogut të lëndës dhe miratim të përgjegjësit të Departamentit të Infermierisë.

Për modulet e integruara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjal i studentit në bazë të shumës së përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Për të marrë një vlerësim pozitiv përfundimtar, studenti duhet të ketë grumbulluar $\geq 40\%$ jo vetëm të totalit të modulit, por edhe të pikëve përkatëse të çdo lënde përbërëse të modulit të integruar.

Neni 11


Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve

Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:

1. Në bazë të rregullores së UV, kontrolli i njohurive në programet mësimore të FSH bëhet me një provim final, si dhe me anë të detyrave të kursit apo skedave të vlerësimit në laboratore dhe praktika mësimore.
2. Pas 48 orësh brenda kryerjes së kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim) pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim.
3. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.
4. N.q.s është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.
5. N.q.s studenti është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit edhe pas sqarimeve të dhëna nga pedagogu i lëndës, paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit për apelimin e vlerësimit që ka marrë.
6. Në bazë të kësaj kërkesë departamenti ngre një komision apelimi *ad hoc* për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tre ditëve nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.
7. Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.

Neni 12

Rikontrollimi i dijeve të fituara



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Studentët që kanë ndërprerë përkohësisht studimet duhet tu nënshtrohen kontrolleve për verifikimin dhe vlerësimin periodik të krediteve të fituara, kontrolle këto për të garantuar mosvjetërimin e dijeve dhe përditësimin e tyre për kreditet e fituara më parë.

Edhe studentët që u kanë zgjatur studimet më shumë se dy vjet përtej kohës normale të fitimit të diplomës për DP në "Asistencë në Geriatri" para dhënies së tezës së diplomës iu kontrollohen kreditet e fituara.

Neni 13

Orari i studimit dhe provimeve

Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimi përcaktohet në orarin e shpallur nga Departamenti i Infermierisë. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësimdhënësit e Universitetit.

Orari i përgjithshëm i Universitetit duhet të shpallet të paktën 3 javë përpara fillimit të semestrit. Orari i provimeve finale duhet të shpallet jo më vonë se 2 javë para fillimit të sezonit të provimeve.

Orari duhet të jetë i detajuar me sallat përkatëse dhe mund të ndryshojë vetëm me miratimin e Drejtuesit të Departamentit dhe Dekanit të FSHP.

Neni 14

Detyrimet e mundshme, që lidhen me frekuentimin.

- Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 70%.
- Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 80%.
- Frekuentimi i praktikave profesionale është i detyrueshëm në masën 100%.
- Frekuentimi i laboratoreve është i detyrueshëm në masën 100%.

Nëse, për arsye objektive, do të ketë mungesa në orë të veçanta laboratorike dhe praktike, do të gjendet koha e përshtatshme për zëvendësimin e tyre.

Neni 15

Organizimi i praktikës në programet e ciklit të parë të studimit

Praktikat mësimore dhe profesionale të programit DP në "Asistencë në Geriatri" në Departamentin e Infermierisë zhvillohen në institucionet e Shërbimit Shëndetësor Parësor dhe Dytësor (në bazë të marrëveshjeve paraprake me këto institucione), institucione të kujdesit për të moshuar (shtëpi për të moshuar) [në bazë të marrëveshjeve paraprake me këto institucione] sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga Departamenti.

Organizimi i praktikave mësimore:

1. Kohëzgjatja e praktikave profesionale sipas planit mësimor është 7 javë në fund të vitit të parë / semestri i dytë dhe 15 javë në vitin II / semestri II, 7 orë në ditë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

2. Pasi është realizuar ndarja e grupit të leksionit në disa grupe praktike, Drejtuesi i departamentit u ndan grupet e praktikës pedagogëve përgjegjës. Titullari i lëndës u prezanton pedagogëve të praktikës, syllabusin e lëndës dhe objektivat e saj. Pedagogu përgjegjës për praktikën/udhëheqësi i praktikës merr nga sekretaria mësimore listën e studentëve të regjistruar në grupin e praktikës mësimore/profesionale.
3. Detyrat e udhëheqësit të praktikës mësimore janë:
 - Organizon punën e studentëve në institucionin përkatës në bashkëpunim me personelin infermieror.
 - Kontrollon ndjekjen korrekte të praktikës mësimore prej studentëve të kursit.
 - Realizon mësimdhënie klinike: diskuton me studentët rastet e paraqitura në pavion/institucione parashkollore, pyet studentët për aspektet teorike të diagnostikës dhe terapisë (të trajtuara paraprakisht në leksione).
 - Ndjek angazhimin/integrimin e studentëve në kryerjen e procedurave të profesionistëve infermierorë.
 - Organizon punën e pavarur të studentëve mbi bazën e detyrave të kursit apo projekteve klinike të përbashkëta.
 - Dorëzon në fund të çdo jave mësimore mungesat e studentëve në praktikat përkatëse.
 - Vlerëson performancën e studentit në praktikën mësimore nëpërmjet një skede vlerësimi, të cilën e dorëzon në fund të semestrit përkatës në sekretarinë mësimore.
 - Përpara provimit final, dorëzon tek lektori i lëndës dhe sekretaria mësimore, listën e studentëve me frekuentimin e orëve mësimore dhe studentët të cilët nuk futen në provim për arsye mungesash.
 - Përpara provimit final udhëheqësi i praktikës mësimore dorëzon në sekretarinë mësimore dhe tek lektori i lëndës
 - Skedën e vlerësimit të performancës së studentit në praktikën mësimore (shtojca nr. 4 e rregullores së Departamentit të Infermierisë).
 - Vlerësimin vjetor të studentit (1-10%).
 - Organizon dhe lehtëson punën e pavarur të studentëve mbi bazën e projekteve klinike apo temave të diplomës.
 - Vlerëson performancën e studentit në praktikën profesionale nëpërmjet një skede vlerësimi, të cilën e dorëzon në fund të semestrit përkatës.
1. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces mësimor.
2. Përpara provimit të praktikës udhëheqësi i praktikës profesionale dorëzon në sekretarinë mësimore:
 - Raportin e frekuentimit të praktikës profesionale nga studentët (rregjistri akademik).
 - Skedën e vlerësimit të performancës së studentit në praktikën profesionale (shtojca nr. 4 e rregullores së departamentit).

Neni 16

Karakteristikat e Detyrave/Projekteve të kursit



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Detyrat dhe projektet e kursit në programin DP në "Asistencë në Geriatri" do të jenë të karakterit deskriptiv. Kërkesat për secilin tip paraqiten më poshtë:

STUDIMI DESKRIPTIV

Hyrja – bëhet një parashtrim i shkurtër i përmbajtjes së punimit, duke theksuar çfarë sjell të re ky studim, çfarë ka interesante dhe të rëndësishme që t'ia vlejë për t'u lexuar.

Fjalët kyçe – emërtimet kryesore dhe më të shpeshta të punimit.

Referimi i literaturës – bëhet përmbledhja e literaturës së studiuar mbi temën e punimit. Përmenden punime të ngjashme dhe krahasohen konkluzionet. Trajtohet gjerësisht problemi nga ana teorike dhe studimore.

Referimi i literaturës së huaj bëhet me përpikmëri. Për çdo paragraf vendoset numri korrespondues me literaturën nga është marrë, që është listuar tek sektori 'Referencat'. Nuk lejohet citimi i asnjë paragrafi i pashoqëruar me referimin përkatës.

Qëllimi dhe Metoda – paraqitet çfarë qëllimi ka studimi, objektivat e përgjithshme dhe specifike, si dhe metodat dhe instrumentat e përdorur për realizimin e këtyre qëllimeve dhe objektivave. Përshkruhet me hollësi e gjithë metodologjia e punës, çdo veprim i kryer, p.sh: studimi i kartelave, krahasimi i protokolleve të trajtimit, aplikimi i planeve të asistencës, plotësimi i pyetsorëve, mbledhja e të dhënave nga statistikat, shqyrtimi klinik i rasteve.

Rezultatet – paraqiten të gjitha të dhënat e mbledhura në tabela dhe në paraqitje grafike. Grafikët shoqërohen me komente sqaruese.

Diskutimi – komentohen të dhënat e mbledhura në funksion të përmbushjes së qëllimit dhe objektivave.


Konkluzionet dhe Rekomandimet – bëhet një përmbledhje e rezultateve të evidentuara dhe jepen rekomandimet për përmirësime në politikat shëndetësore aktuale apo për ngritjen e politikave të reja (parandaluese, diagnostikuese, terapeutike, etj)

Referencat – çdo libër referohet me titull, emër autori, vit botimi, ISBN dhe faqet nga është marrë citimi. Nëse referimi është nga interneti, vendoset adresa e plotë e internetit. Listimi i literaturës bëhet sipas renditjes alfabetike.

- ☞ *Temat do të shkruhen në formatin Times New Roman 12.*
- ☞ *Një kopje elektronike do të niset me e-mail*
- ☞ *Një kopje e shkruar do ti dorëzohet pedagoges*
- ☞ *Punimet do të prezantohen në formatin Ms.PowerPoint gjatë dy javëve të fundit të semestrit.*
- ☞ *Çdo student do të prezantojë pjesën me të cilën ka punuar më shumë.*
- ☞ *Pas prezantimit do të ketë pyetje dhe diskutime.*
- ☞ *Vlerësimi në fund është individual.*

Neni 17

Modalitetet për mbrojtjen e diplomës në programin DP në "Asistencë në Geriatri"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Mbrojtja e Diplomës në përfundim të programit parashikohet me provim formues ose me pregatitjen e një teze diplome.

- Mesatarja e notave për marrjen e temës së diplomës përcaktohet me vendim të SA, pas propozimeve të departamentit.
- Studentëve të programit u llogaritet mesatarja e ponderuar në bazë të notave të marra gjatë 3 semestrave të parë.
- Studentët të cilët gjatë semestrave paraprakë të studimeve kanë një mesatare aritmetike të lëndëve më të ulët se mesatarja e parashikuar nga SA, ose që nuk dëshirojnë të realizojnë temë diplome, do të diplomohen nëpërmjet provimit të përgjithshëm formues.

Neni 18

Mbrojtja e diplomës me provim formues të përgjithshëm

1. Studentët që nuk e arrijnë mesataren e përcaktuar me vendim SA diplomohen me provim të përgjithshëm teorik.
2. 3 muaj përpara sezonit të provimit të diplomës, departamenti përcakton lëndët e formimit karakterizues dhe me zgjedhje të programit, që do të përfshihen në provimin e përgjithshëm përfundimtar. Titullarët e lëndëve dorëzojnë në departament temat e përzgjedhura për secilën lëndë, nga të cilat do të nxirren pyetjet e provimit.
3. Lista e temave mësimore që do të pyeten në provimin e diplomës vihet në dispozicion të studentëve 2 muaj përpara sezonit të diplomës (fotokopje, afishim në ambiente të dukshme, web-i i UV, facebook-u i FSH).
4. Informimi i studentëve për formën e vlerësimit të njohurive (formën e provimit) bëhet 2 muaj përpara përfundimit të semestrit.
5. Hartimi i tezës së provimit të diplomës:
 - Banka e pyetjeve për secilën lëndë, së bashku me pikët maksimale për çdo pyetje, do të dorëzohet e firmosur prej titullarit të lëndës tek drejtuesi i departamentit, 1 javë përpara sezonit të diplomimit.
 - Pyetjet janë të formuluar përgjithësisht në formë quiz-esh dhe pyetjesh shtjelluese. Çdo pyetje duhet të shoqërohet me numrin e pikëve maksimale, që mund të merren prej saj.
 - Formulimi i tezës së provimit bëhet nga Drejtuesi i departamentit. Ai përzgjedh nga banka e pyetjeve një përqindje të caktuar të pyetjeve prej secilës lëndë, sipas vlerës specifike të krediteve që ka lënda: lëndët me më shumë kredite do të kenë edhe përqindjet më të larta të pikëve në provim. Në total shuma e pikëve maksimale të të gjitha pyetjeve të përfshira në tezën e provimit të diplomës është 100 pikë.
 - Minimalisht hartohen 6 (gjashtë) teza provimi.
6. Elementet e tezës së provimit janë:
 - Emri: Teza e provimit të diplomës në programin
 - Sezoni i diplomimit
 - Varianti i tezës
 - Drejtuesi i departamentit: emri, firma
 - Dekani i FSH: emri, firma, vula e njësisë kryesore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

- Çdo pyetje duhet të shoqërohet me numrin e pikëve maksimale, që mund të merren prej saj.
 - Pyetjet e të njëjtës lëndë janë të grupuara në një faqe. Çdo fletë e tezës ka pyetje vetëm të një lënde. Teza ka aq fletë sa lëndë janë përfshirë në të (plus fletët e bardha që mund tu duhen studentëve për të zhvilluar përgjigjet).
7. Pas marrjes në dorëzim të procesverbalit të vlerësimit të provimeve, drejtuesi i departamentit u komunikon privatisht studentëve sasinë e pikëve të marra dhe notën përkatëse.
 8. Studenti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për vlerësimin e marrë nga pedagogu që ka bërë korrigjimin.
 9. Në rast pakënaqësie studenti ndjek procedurën e apelimit të notës, si në provimet e lëndëve.
 10. Procesverbali përfundimtar i vlerësimeve në provimin e diplomës dorëzohet në sekretari nga drejtuesi i departamentit. Ai firmoset nga gjithë pedagogët që kanë marrë pjesë në korrigjimin e tezës.

Neni 19

Karakteristikat e Tezës së Diplomës

Projektet e Tezës së Diplomës duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

- Të jenë studime deskriptive
- Jo domosdoshmërisht origjinale,
- Me udhëheqje shkencore apo krejtësisht të pavarura
- Të plotësojnë kërkesat e renditura në Nenin 16 për studimet deskriptive.

Neni 20

Modalitetet për marrjen e diplomës në programin DP në "Asistencë në Geriatri"

1. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në të gjitha modulet e detyrueshme në disiplinat:
 - e formimit bazë
 - karakterizuese
 - ndërdisiplinore, të lidhura me disiplinat karakterizuese
 - praktikën profesionale
2. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në:
 - 1 modul të disiplinave me zgjedhje
3. Studenti duhet të ketë vlerësim 'kalues' në tezën e diplomës, sipas kërkesave të paraqitura në Nenin 19 të Rregullores së këtij programi mësimor.
4. Në përfundim të studimeve të ketë grumbulluar jo më pak se 120 ECTS (kredite).

Procedura e diplomimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

1. Studentët që kanë plotësuar detyrimet e një programi studimi dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit pajisen me diplomë, e cila është një dokument zyrtar.
2. Përmbajtja dhe forma e Diplomës, si dhe formati i Suplementit të Diplomës është i përcaktuar nga MAS në udhëzimin përkatës.
3. Modalitetet e prodhimit dhe shpërndarjes së diplomave përcaktohen në Rregulloren dhe Statutin e UV.
4. Studenti paraqet në Sekretarinë mësimore të Fakultetit të Shëndetit kërkesën për diplomim, së bashku me gjeneralitetet personale.
5. Në bazë të kërkesës së studentit merret një kopje e listës së notave të studentit nga sekretaria mësimore.
6. Komisioni i verifikimit të transkripteve verifikon plotësimin e kriterëve të diplomimit për DP "Asistence në Geriatri".
7. Nëse pas verifikimit konstatohet se studenti i ka plotësuar kriteret për t'u diplomuar, Departamenti i Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit paraqet në Rektorat aprovimin e diplomimit të studentit në fjalë.
8. Pasi Rektori i Universitetit "Ismail Qemali"-Vlorë aprovon kërkesën për diplomim Sekretaria mësimore e FSH plotëson Diplomën dhe suplementin e Diplomës për çdo student.
9. Diplomat shoqërohen me suplementin. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës.
10. Studenti merr formularin për marrjen e diplomës tek sekretaria mësimore dhe paraqitet në Bankë për të bërë pagesën.
11. Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari gjatë ceremonisë së diplomimit ose në zyrën e Kryesekretares së FSH, sipas Rregullores së UV (neni 64).
12. Nëse studentit i nevojitet programi i plotë mësimor, merr formularin për program tek sekretaria mësimore, bën pagesën tek cdo lloj banke, dhe më pas tërheq programin e firmosur dhe të vulosur nga Rektori pranë sekretarisë mësimore të FSH.

Neni 21

Shkeljet e rregullave të fakultetit

Shkelje të rregullave të FSH konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që çënojnë personalitetin e mësimdhënies dhe të çdo punonjësi tjetër të shkollës, normat etiko-morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj, kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale.

Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto masa disiplinore:

- vërejtje me shkrim;
- përjashtim nga shkolla për një vit;
- përjashtim nga Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës;
- përjashtim përgjithmonë nga Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës;



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Vendimin për përjashtimin e studentit një vit nga shkolla e merr Dekanati i Fakultetit të Shëndetit.

– Vendimin për përjashtimin nga Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës;

(heqje vetëm e së drejtës së studimit të filluar) dhe përjashtimin përgjithmonë nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës (duke mos i lejuar të fitojë të drejta studimi të mëpasshme) e merr Rektorati i Universitetit Ismail Qemali të Vlorës, mbi bazën e propozimit të Dekanatit.

Neni 22.

Shkeljet e integritetit akademik

Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik në Fakultetin e Shëndetit - UV duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standartet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Prezantimi i keq i vetvetes dhe punës është mashtrim sepse do të thotë që studentët pretendojnë kredite për ide apo punë që nuk janë në të vërtetë vepër e tyre dhe në këtë mënyrë kërkojnë një diplomë që në të vërtetë nuk është fituar. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

1. Mashtrim në provime. Këtu përfshihen të përdorësh materiale si libra dhe/ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhësh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjelljen gjatë provimeve.

2. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër pa i dhënë atij personi kredit për punën e vet; duke bërë këtë studentët pretendojnë kredit për mendimin e dikujt tjetër. Studentët duhet të dokumentojnë gjithmonë burimin e informacionit qoftë atëherë kur e kanë lexuar edhe atëherë kur e kanë dëgjuar. Kur punohet me burime të shkruara, një dallim i qartë duhet bërë midis thonjzave (të cilat riprodhojnë informacionin fjalë për fjalë nga burimi dhe e vendosin atë midis thonjzave) dhe perifrimeve (të cilat e përpunojnë burimin e informacionit dhe e paraqesin atë me fjalët e studentit. Qoftë citimet midis thonjzave, qoftë perifrimezimet duhen të dokumentohen në çdo rast. Edhe në rastin kur studentët rishprehin, përmbledhin apo përzgjedhin pjesë nga puna e tjetrit, idetë i përkasin në çdo rast personit tjetër, dhe mosdhënia kredit punës së tij përbën prezantim të keq të punës aktuale të studentit dhe plagjiaturë e ideve të dikujt tjetër. Të blesh një detyrë kursi ose të përdorësh informacion nga Rrjeti Ndërkombëtar i Informacionit ose Interneti pa njohur burimin dhe ta dorëzosh atë si punë vetjake është plagjiaturë.

3. Mashtrim në raporte laborator duke falsifikuar të dhëna apo duke dorëzuar të dhëna të pabazuara në punën vetjake të studentit është shkelje.

4. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

5. Bashkëpunimi i paautorizuar në detyra kompjuterike dhe hyrje e paautorizuar dhe përdorimi i programeve kompjuterikë duke përfshirë modifikimin e skedar kompjuterikë të krijuar nga të tjerë dhe të paraqesësh atë punë si punën tënde është shkelje. Me përjashtim të rasteve kur japin udhëzime specifike, në të gjitha rastet pedagogët presin prej studentëve punë individuale pa ndihmën e të tjerëve në detyra kursi, provime, raporte laboratorit dhe ushtrime kompjuterike, si dhe dokumentacion të të gjitha burimeve në rastet kur këto vihen në përdorim. Studentët nuk duhet të dorëzojnë punën e kryer në një kurs që është marrë në të kaluarën apo për një kurs bashkëekzistues, përveç rasteve kur studenti ka leje të qartë për të bërë kështu nga të dy anëtarët e personelit akademik që janë pedagogë të kurseve.

Neni 23

Kushtet për procedurat e modalitetet për ndërprerjen e studimeve

Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë të vitit, për një afat jo më tepër se një vit dhe vetëm për këto raste:

- Kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport nga komisioni mjekoligjor, ku të jenë shprehur qartë diagnoza e rekomandimi. Dokumentat duhet të paraqiten përpara shkëputjes nga Universiteti të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit.
- Kur mbetet kryefamiljar, në raste fatkeqësish e në kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara nga zyrat e Pushtetit Lokal. Këto dokumenta duhet të paraqiten përpara shkëputjes nga Universiteti të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit.

Studentët të cilët ndërpresin studimet për dy ose më shumë semestra rradhë, duhet të aplikojnë përsëri për pranim në Universitet. Vendimi merret nga një komision i ngritur nga Rektori.

Neni 24

Kushtet për procedurat e modalitetet për transferimin e studentëve

Procedurat transferuese në Fakultetin e Shëndetit përcaktohen në rregulloren e Universitetit 'Ismail Qemali' të Vlorës. Procedurat transferuese përfundojnë përpara para fillimit të semestrit.

Studentët e Fakultetit të Shëndetit - UV të cilët duan të transferohen në universitete të tjera të vendit, në të njëjtën degë dhe sistem, paraqesin kërkesën në sekretarinë mësimore të FSH për tërheqjen e listës së notave. Pas përgjigjes së pranimi nga universiteti pritës, përcillet dokumentacioni i plotë i studentit; detyrimet e shlyera me notat përkatëse, dëftesa e shkollës së mesme, dokumentacioni i bursës, etj. Pas kryerjes së transferimit studenti humb statusin e studentit të UV.

Për studentët që duan të transferohen në FSH, Komisioni i ekuivalentimit të moduleve dhe krediteve të programeve mësimore të FSH, mbi bazën e dokumentacionit që dërgon universiteti përkatës, përcakton detyrimet që do të ketë studenti, nëse pranohet në atë degë,



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

sipas planit mësimor në fuqi si dhe njohjen e shlyerjes së lëndëve me ekuivalencë. Këto transferime bëhen sipas akteve ligjore të miratuara nga MASR.

Fakulteti i Shëndetit njih si kredite të formimeve universitare në programin DP në "Asistencë në Geriatri" njohuri të veprimtarive formuese (module, praktika profesionale) të nivelit pas shkollës së mesme që janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit, numrin e orëve mësimore dhe kurrikulën e modulit minimalisht me 80% të normave të ofruara nga programi mësimor i FSH. Numri maksimal i krediteve të njohura në këtë rast nuk i kalon 60 ECTS. (neni 2.1, pika e, udhëzimi 41 i MASR)

Neni 27

Vazhdimi i mëtejshëm i studimeve

Studentët që përfundojnë programin DP në "Asistencë në Geriatri" me mesatare të lartë (kufiri minimal miratohet në Senatën Akademik të UV pas propozimit të departamentit) kanë të drejtë të kërkojnë vazhdimin e studimeve të tyre në nivelin bachelor, duke patur parasysh edhe mesataren e shkollës së mesme në kufij të lejuara me ligj.

Nëse kërkesa u pranohet, një pjesë e krediteve të marra në programin DP në "Asistencë në Geriatri" do të njihet në programin pasues. Parimet dhe procedurat e njohjes së krediteve janë të njëjta me ato që ndiqen gjatë transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta.

Neni 28

Këshillimi dhe tutoriati i studentëve

1. Pranë Departamentit të Infermierisë funksionon Zyra e Këshilltarit Akademik të Departamentit, që është një strukturë për orientimin dhe këshillimin e studentëve nga regjistrimi në programin mësimor deri në marrjen e licencës për ushtrimin e profesionit.
2. Këshilltari akademik i departamentit është në dispozicion për ndihmë në të kuptuarit e kërkesave të pranimit në programe të caktuara, si dhe të kërkesave të Fakultetit dhe të programit të diplomimit.
3. Këshilltari akademik emërohet çdo fillim viti akademik.
4. Pas marrjes së emërimit, këshilltari akademik formon "Grupin e Tutoriatit të Studentëve" me studentë të viteve të fundit të studimit.
5. Këshilltari akademik, bashkë me "Grupin e Tutoriatit" kontaktojnë me studentët që me paraqitjen e tyre për regjistrim në sekretarinë mësimore të departamentit, në ditën e parë të fillimit të shkollës (në sallën e leksioneve) dhe në vazhdim sipas kërkesës së studentëve për këshillim.
6. Këshilltari akademik i departamentit dhe studentët e angazhuar për tutoriat duhet të sqarojnë studentët mbi:
 - a. Ku mund ta lexojnë rregulloren e departamentit dhe të fakultetit.
 - b. Ku të gjejnë informacion:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETTIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

- çfarë mund të gjejnë tek web-i i UV (www.univlora.edu.al),
 - çfarë mund të gjejnë tek faqja e facebook-ut (Fakulteti i Shëndetit - Vlorë)
 - c. Si të përdorin UMS.
 - d. Si bëhen rregjistrimet nëpër kurse.
 - e. Planet mësimore:
 - cilat janë veprimtaritë mësimdhënëse,
 - si shpërndahet plani sipas viteve,
 - si kalohet nga një vit në tjetrin (30 kredite – viti i parë),
 - Në disa programe studentët duhet të paraqesin një program plani të shkruar. Këshilltari akademik mund t'i ndihmojnë studentët të përpilojnë të tilla plane, si dhe të verifikojnë që të gjitha detyrimet e kursit po shlyhen në kohën e duhur.
 - f. Çfarë është shpjegimi i syllabyseve dhe kur bëhet.
 - g. Cilat janë lëndët e detyruara, si veprohet me lëndët me zgjedhje.
 - h. Orari i sezonit: ku ndodhen klasat ku zhvillohen leksionet, seminarët.
 - i. Si dhe ku zhvillohen labororet, praktikat. Cilat janë kërkesat e paraqitjes profesionale në orët e laboratorëve dhe praktikave.
 - j. Format e vlerësimit (si zhvillohen provimet)
 - k. Procesi i ankimimit të pikëve të marra në provime.
 - l. Ku mund të gjejnë literaturën e kërkuar nga pedagogët
 - m. Ç'kërkohet në detyrat e kursit?
 - n. Riprovimet:
 - me sa kredite futesh në sezonin e riprovimeve,
 - kush ka të drejtë të futët në riprovim (m, 4, NP)
 - o. Dënimet për mashtrim në provim, plagjiaturë
 - p. Etika e sjelljes dhe marrdhënieve institucionale gjatë praktikave në institucionet shëndetësore.
 - q. Pyetësorët periodikë që do të plotësojnë për performancën e pedagogëve dhe opinionet për efikasitetin e programeve mësimore.
 - r. Vendndodhjen e sekretarisë, bibliotekës, sekretarisë.
 - s. Vendndodhjen e konviktit, dyqaneve, si mund të gjejnë ambiente me qera.
 - t. Çfarë dokumentash shkresore mund të marrin në sekretarine e FSH.
 - u. Kur mund të përfitojnë bursë dhe çfarë procedurash duhet të ndjekin.
 - v. Dokumentat që duhet të përgatisin për të kërkuar punësim sezonal apo të përhershëm jashtë shtetit.
 - w. Këshillim për avancimin e mëtejshëm të studimeve në programet bachelor.
 - x. Këshillim për provimin e liqencës.
7. Ndërsa studentët marrin ndihmë gjatë këshillimit orientues fillestar, ata duhen nxitur që të kërkojnë ndihmë individuale sa më herët që të jetë e mundur në programet e tyre, si dhe që nga ai moment të shkojnë e të takohen rregullisht me këshilltarin e tyre akademik.
8. Këshilltari akademik raporton tek Drejtuesi i Departamentit për mbarëvajtjen dhe problematikat e procesit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

9. Shumicën e kohës këshilltari akademik takohet me studentët në mënyrë individuale në orare të caktuara në marrëveshje me njëri-tjetrin, përveç javës së parë të sezonit, kur këshilltari shkon në auditore për të dhënë sqarime kolektive.

Neni 29

Dispozita të veçanta

1. Proçedurat e hollësishme të procesit të Transferimit të studimeve, Rregullorja e Praktikave profesionale, Rregullorja e Provimeve dhe Rregullorja e Diplomimit janë paraqitur në Rregulloren e Departamentit të Infermierisë.
2. Departamenti i Infermierisë ka të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, sidomos përsa i përket numrit të krediteve që i jepen çdo disipline të veçantë mësimore ose veprimtarie tjetër formuese.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit në Senatin Akademik të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë.

Drejtuese e Departamentit të Infermierisë

Dr. Denada Selfo